

VENDIM
Nr.540, datë 27.7.2011

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.489, DATË 25.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR FONDIN E GARANTIMIT TË KREDIVE TË EKSPORTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 15 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, të nenit 38 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 17 e 18 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kudo në vendimin nr.489, datë 25.7.2007 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “...Agjencia Shqiptare e Investimeve dhe Biznesit (ALBINVEST)...” zëvendësohet me emërtimin “...Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha